

VENDIM
Nr. 649, datë 29.12.1999

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I ASISTENCËS SHËNDETËSORE NË
SITUATA EMERGJENTE NË SHQIPËRI, KRIJIMI I NJË RRJETI INFORMATIV DHE
KOMUNIKIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1.Miratimin e alokimit të shumës grant prej 1.200.000.000 liretash, nga fondi i emergjencës prej 4 miliardë liretash, dhënë nga qeveria italiane për qeverinë shqiptare në vitin 1997.

2.Miratimin e projektit “Përmirësimi i asistencës shëndetësore në situata emergjente në Shqipëri, krijimi i një rrjeti informativ dhe komunikimi” dhe marrëveshjen përkatëse.

3.Miratimin e kontributit prej 27.970.000 lekësh, të qeverisë së Republikës së Shqipërisë në projekt, si kosto lokale e tij, për përballimin e taksave doganore dhe detyrimeve të tjera.

4.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta